



Pranuar / Dorezuar Pritiljeno/Prodato Received/Delivery	31.05.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	2746/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.327/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.2319/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.570/2019 të datës 23.09.2019 të parashtruar nga ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokatit Sylejman Klinaku, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.570/2019 e datës 23.09.2019, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me nr.01-118/02-0043698-2/19 i datës 27.05.2019 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës se Jugut.

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës se Mitrovicës se Jugut, me datë 27.05.2019 ka nxjerr Vendimin Nr.01-118/02-0043698-2/19, përmes të cilit ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga data 27.05.2019, duke u bazuar në kërkesën e saj me numër protokoli 01-118/02-00433698/19 të datës 23.05.2019 për dorëheqje vullnetare nga marrëdhënia e punës.

Ankuesja me datë 07.08.2019 ka parashtruar ankesë me Nr.01-120/01-0070787/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Komunës se Mitrovicës, me arsyetimin se me rastin e paraqitjes se dorëheqjes ka qenë nën ndikimin e terapisë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, nuk e ka shqyrtuar ankesën e ankueses dhe të njëjtën e ka udhëzuar për ushtrimin e mjeteve juridike drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Me datë 23.09.2019, ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokatit ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4484/2019 të regjistruar me numër A.nr.570/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kthimin e saj në vendin e punës Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, me datë 25.09.2010 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Mitrovicës. Këshilli, me datë 08.10.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 08.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2319/19 ndërsa me datë 12.05.2021 ka nxjerr Aktvendimin A.nr.2319/19 për korrigjim të aktgjykimit, dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 23.09.2019 të parashtruar nga

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 4484/2019 të regjistruar me numër A.nr.570/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 24.09.2019; Njoftimin e datës 26.09.2019 lidhur me ankesën A.nr.570/2019; Autorizim për Shërbime Ligjore të datës 23.09.2019; Raportin mjekësor të datës 12.04.2019; E-mailin zyrtar të datës 23.05.2019 të protokolluar me numër protokoli 01-118/02-00433698/19 përmes së cilës ankuesja ka ofruar dorëheqje për arsye personale; Raporti mjekësor i datës 06.08.2019; Rezultati laboratorik i datës 06.08.2019; Kontrolla mjekësore e datës 11.11.2019; Raporti nga konsulta mjekësore e datës 31.08.2019; Dëftesë për pagesë e datës 31.07.2019; Konstatimi radiologjik në QKUK e datës 31.07.2019; Kopja e letërnjoftimit; E-mail i datës 09.08.2019; Aktgjykimi A.nr.2319/19 i datës 08.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe Përgjigja në ankesë e datës 10.10.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuseses *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja ka qenë e punësuar në pozitën e punës Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave në Komunën e Mitrovicës se Jugut. E njëjta, me datë 23.05.2019 përmes emailit zyrtar të protokolluar me numër 01-118/02-00433698/19 ka ofruar dorëheqje nga marrëdhënia e punës, për arsye personale. Kërkesa për dorëheqje është aprovuar përmes Vendimit Nr.01-118/02-0043698-2/19 të datës 27.05.2019 të Kryetarit të Komunës. Kolegji vlerëson se Kryetari i Komunës se Mitrovicës se Jugut, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.01-118/02-0043698-2/19 të datës 27.05.2019, ka zbatuar nenin 85 dhe 86 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike sepse ankuesja personalisht ka parashtruar kërkesë me shkrim për dorëheqje. Kolegji, po ashtu konstaton se i punësuar që ka humbur statusin e nëpunësit civil, nuk mund të rikthej statusin në mënyrë automatike, por përmes ndjekjes së procedurave të rekrutimit siç përcaktohet me nenin 86 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimi ankimor i ankuseses në këtë kuptim është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.372/2021

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, avokatit,
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

